

R R E G U L L O R E

PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TË VEPRUAR SI BANKË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1. Kjo rregullore përcakton kushtet, afatet dhe procedurat e dhënies së licencave për krijimin e bankave të nivelit të dytë.

1.2. Licenca jep të drejtën për të kryer transaksione bankare vetëm në pajtim me ligjin nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar në Shqipëri”.

KREU II DHËNIA E LICENCAVE PËR TË VEPRUAR SI BANKË

Neni 2

2.1. Në mbështetje të ligjit nr.7560, datë 28.4.1992, neni 3, tipet e bankave të cilat mund të paraqesin kërkesë për licencë, janë:

2.1.a. Bankë me kapital tërësisht shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

2.1.b. Bankë Aksionare me përgjegjësi të kufizuar me kapital tërësisht shqiptar (ku aksionere mund të jenë shteti shqiptar, firma dhe shtetas të Republikës së Shqipërisë).

2.1.c. Bankë Kooperative me kapital të personave juridikë e fizikë të Republikës së Shqipërisë.

2.1.d. Bankë Private me kapital tërësisht të personave juridikë e fizikë të Republikës së Shqipërisë.

2.1.e. Bankë Private me kapital të personave juridikë e fizikë të Republikës së Shqipërisë dhe të huaj.

2.1.f. Bankë Shtetërore me kapital të shtetit shqiptar e të shteteve të huaja.

2.1.g. Bankë Private me kapital tërësisht të huaj e cila mund të jetë:

i- Degë e një banke private të huaj;

ii- Bankë e firmave private të huaja;

iii- Bankë e shtetasve të huaj.

2.2. Shuma minimale e kapitalit të parprekshëm të nënshkruar (autorizuar) për një bankë është jo më pak se:

(në milionë lekë)

	Për një bankë kombëtare	Për një bankë rajonale
2.1.a	700	300
2.1.b	300	100
2.1.c	-	50
2.1.d	150	100
2.1.e	200	100
2.1.f	700	300
2.1.g		
i	300	-
ii	200	100
iii	150	100

2.3 Banka e Shqipërisë mund të kërkojë një kapital të nënshkruar më të madh nëse e

gjykon se rrethanat e kërkojnë një gjë të tillë.

2.4 Shuma minimale e kapitalit të paprekshëm e përcaktuar në pikën 2.2 më sipër nuk është përfundimtare. Bankat janë të detyruara të plotësojnë kërkesën për mjaftueshmërinë e kapitalit gjatë veprimtarisë së tyre sipas udhëzimeve të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, mbështetur në nenin 27, gërma a e ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar në Shqipëri”.

2.5 Në përputhje me nivelin e inflacionit, Banka e Shqipërisë ricakton shumën minimale të kapitalit të paprekshëm të nënshkruar (autorizuar).

2.6 Në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencë, duhet të jetë paguar plotësisht jo më pas se 1/4 e shumës minimale të kapitalit të paprekshëm të Bankës. Pagimi i pjesës së mbetur do të bëhet në këto afate:

a- Për bankat që shumën minimale të kapitalit të paprekshëm të nënshkruar (autorizuar), e kanë deri në 100 milionë lekë:

- Deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për të filluar kryerjen e transaksioneve bankare (sipas nenit 8 të kësaj rregullore) 100 për qind

b- Për bankat që shumën minimale të kapitalit të paprekshëm të nënshkruar (autorizuar), e kanë mbi 100 milionë lekë deri në 200 milionë lekë:

- b.1 - Deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për të filluar kryerjen e transaksioneve bankare (sipas nenit 8 të kësaj rregullore) 50 për qind.
Por në asnjë rast, totali i kapitalit të paguar (në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencë së bashku me atë të paguar deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për të filluar kryerjen e transaksioneve bankare), nuk duhet të jetë më i vogël se 100 milionë lekë.

- b.2. - Brenda një viti pas fillimit të veprimtarisë (me kuota të barabarta çdo gjashtë muaj) - Pjesa e mbetur deri në 100% të kapitalit.

c- Për bankat që shumën minimale të kapitalit të paprekshëm të nënshkruar (autorizuar), e kanë mbi 200 milionë lekë:

- c.1 - Deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për të filluar kryerjen e transaksioneve bankare (sipas nenit 8 të kësaj rregullore) - 50 për qind
- c.2 - Brenda dy viteve pas fillimit të veprimtarisë (me kuota të barabarta çdo gjashtë muaj) 50 për qind.

Departamenti i Mbikëqyrjes mund t'i kërkojë bankave që pagesën e pjesës së mbetur të shumës minimale të kapitalit të paprekshëm (të gërmave b.2 dhe c.2) ta bëjnë në një kohë me të shkurtër, në rast se kjo del e nevojshme për të respektuar kërkesat e rregullores së Bankës të Shqipërisë “Për mjaftueshmërinë e fondeve të veta (kapitalit)”.

2.7. Një Bankë private me kapital tërësisht të huaj sipas nenit 2.1/g, në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencë, duhet të ketë paguar plotësisht shumën minimale të kapitalit të paprekshëm të nënshkruar (autorizuar), me përjashtim të rasteve kur me ligj tjetër apo me miratim të veçantë nga Banka e Shqipërisë është parashikuar ndryshe.

2.8. Bankat konsiderohen kombëtare kur ato kanë degë në pesë ose më shumë rrethe të Republikës së Shqipërisë, si dhe gjithë degët e bankave private të huaja.

2.9 Të drejtën për të kërkuar licencë për të vepruar si bankë, e kanë personat juridikë e fizikë të cilët vërtetojnë se pasuria e tyre neto është jo më pak se trefishi i pjesës që ato nënshkruajnë në kapitalin e bankës. Prioritet, do të kenë personat me pasuri më të madhe. Përjashtime nga ky rregull mund të bëhen nga Banka e Shqipërisë sipas gjykimit rast pas rasti.

2.10 Personat të cilët kanë marrë licencë për të vepruar si bankë e fitojnë të drejtën që t'i kryejnë të gjitha transaksionet bankare, nëse në tekstin e licencës nuk përmbahen kufizime të thëna shprehimisht (licencë e kufizuar).

2.11 Në raste të veçanta Banka e Shqipërisë kufizon ose përjashton në licencë kryerjen e veprimeve që, sipas gjykimit të saj, kërkojnë kualifikim të veçantë dhe pajisjet e nevojshme.

2.12 Për disa lloje specifike operacionesh bankare, jepet licencë speciale ku specifikohet lloji dhe mënyra e caktuar për të kryer transaksionet bankare, sferën e tyre të veprimtarisë dhe karakteristikat e tyre dalluese.

KREU III KËRKESAT PËR DHËNIEN E LICENCEVE, SI DHE KUSHTET E PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E TYRE

Neni 3

Personat fizikë apo juridikë që kërkojnë t'u jepet licencë për të vepruar si bankë, i dërgojnë Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet drejtorit të departamentit të mbikëqyrjes, dokumentet e poshtëshënuara.

Personat fizikë apo juridikë vendas, gjithë dokumentacionin e paraqesin në gjuhën shqipe. Personat fizikë apo juridikë të huaj dokumentacionin e paraqesin në tre kopje, (në gjuhën shqipe, në gjuhën e vendit të vet dhe në anglisht) dhe dokumentacioni në gjuhën shqipe të jetë i vërtetuar nga një noter në Shqipëri.

3.1 Për themeluesit dhe administratorët e bankës

3.1.1 Lista e të gjithë themeluesve të bankës, kombësia, shtetësia, adresa e vendbanimit të tyre, arsimi, punësimi i shkuar e aktual dhe përvoja në biznes. Deklarata e tyre për themelimin e bankës e nënshkruar para një noteri, si dhe një kopje e vendimit të organit kompetent të bankës për zgjedhjen apo emërimin e administratorëve të bankës, të cilët do ta drejtojnë dhe përfaqësojnë bankën.

3.1.2 Të dhëna për administratorët e Bankës, kombësia, shtetësia, adresa e vendbanimit të tyre, arsimi, punësimi i shkuar e aktual, përvoja në veprimtarinë bankare, reputacioni i tyre, nëse kanë ose jo pengesa ligjore, etj. sipas udhëzimit të Bankës së Shqipërisë, nr.896, datë 11.8.1993 "Për minimumin e kërkesave që duhet të plotësojnë administratorët dhe drejtuesit e bankave tregtare".

3.1.3 Raporti financiar personal "sekret" i çdo themeluesi dhe administratori të bankës, për tre vitet e fundit (pasuria neto, të ardhurat, shpenzimet dhe të dhëna të tjera financiare të nevojshme).

3.1.4 Lista e bizneseve ku ata marrin pjesë, duke përfshirë ato biznese ku zotërojnë aksione, kanë lidhje biznesi ose ku ata kryejnë funksione drejtuese.

3.1.5 Raportet financiare të bizneseve ku pronësia e tyre është e ndjeshme apo në të cilat ata kanë funksione drejtuese.

3.1.6 Një vërtetim nga organet kompetente ku të tregohet nëse është vendosur ndonjë gjobë për shmangie nga pagimi i tatimeve e taksave gjatë dy viteve të fundit.

3.1.7 Të dhëna që nuk ka qenë anëtar i ndonjë organi ekzekutiv apo kontrollues ose ortak në një firmë, kompani apo ortakëri, të cilat kanë qenë shpërndarë për shkak të paaftësisë paguese në rastin kur kreditorët mbeten të pakënaqur.

3.1.8 Të dhëna për emrat, adresat e banimit të bashkëshortit/bashkëshortes ose të afërmëve të drejtpërdrejtë ose të tërthortë deri në tre breza.

3.1.9 Një vërtetim që nuk janë dënuar më parë nga gjykata për krime të tilla si vjedhje, ryshfet, fshehje fitimesh për shmangie nga pagimi i tatimeve e taksave, faliment, nxjerrje sekreti ose me heqje lirie për arsye të tjera, si dhe një vërtetim nga organet kompetente që ndaj tyre nuk është filluar ndonjë çështje penale.

3.1.10 Themeluesit që janë persona juridikë ose fizikë të huaj, të paraqesin edhe një deklaratë nga organet kompetente të vendit të vet ku të specifikohet, nëse legjislacioni i vendit të tij i lejon të kryejnë veprimtari bankare (si bankë), në Shqipëri.

3.2 Për strukturën e kapitalit të bankës.

3.2.1 Shuma minimale e kapitalit të paprekshëm të nënshkruar.

3.2.2 Pjesa e secilit themelues në kapitalin e nënshkruar (lista duhet të nënshkruhet nga të gjithë themeluesit) e vërtetuar nga noteri.

3.2.3 Lista për pjesën e kapitalit të paguar nga çdo themelues dhe nënshkrimi i tyre.

Bashkëlidhur një dokument bankar që vërteton se është depozituar (derdhur) shuma minimale e kapitalit të paprekshëm të paguar në një llogari të bllokuar në Bankën e Shqipërisë.

3.2.4 Në qoftë se themeluesit mendojnë se kapitalin do ta sigurojnë nga publiku nëpërmjet aksioneve, duhet të paraqesin një përshkrim se si ata parashikojnë ta sigurojnë kapitalin dhe të japin informacion të mjaftueshëm për të argumentuar aftësinë e tyre për të qënë të suksesshëm për sigurimin e kapitalit nga publiku.

Depozitimi i shumës minimale të kapitalit të paprekshëm të paguar bëhet sipas nenit 3.2.3.

3.3 Për planin e biznesit të bankës

3.3.1 Statuti i bankës i hartuar në pajtim me ligjin “Për sistemin bankar në Shqipëri”.

3.3.2 Specifikime të detajuara të transaksioneve e shërbimeve që do të kryejë banka duke i ndarë në ato që do të kryhen në fillim të veprimtarisë dhe ato që do të kryhen dy-tre vitet e ardhshme.

3.3.3 Përcaktimi i vendndodhjes së Bankës së re, si dhe plani i zgjerimit të rrjetit për dy-tre vitet e ardhshme.

3.3.4 Përshkrimi i përgjithshëm i tregjeve primare e sekondare ku banka do ta shtrijë veprimtarinë e saj.

3.3.5 Përshkrimi i llojeve të pajisjeve teknike operationale që banka parashikon të përdorë.

3.3.6 Struktura organizative, përshkrime të shkurtra të funksioneve të çdo njësie, si dhe numri i punonjësve. Këtu duhet të jepet edhe informacion se cili nga themeluesit apo administratorët do të jenë edhe anëtarë të Këshillit të Mbikëqyrjes, Këshillit Drejtues dhe Komitetit të Kontrollit të Bankës. Për bankat me kapital tërësisht të huaj, jo më pak se 50 për qind e personelit drejtues duhet të jenë shtetas shqiptarë.

3.3.7 Një përshkrim i hollësishëm i strategjisë së themeluesve dhe administratorëve për një veprimtari të suksesshme të Bankës.

3.3.8 Projektprogrami financiar për tre vitet e para të veprimtarisë, së bashku me parashikimin e disa treguesve të tillë si: llojet e kredive dhe depozitave që banka mendon të aplikojë, ritmet e zhvillimit, normat e interesave, të ardhurat, shpenzimet etj. Të jepet pasqyra e llogarive të aktiveve e pasiveve të bankës në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencë dhe për çdo vit, për tre vitet e para të veprimtarisë.

3.3.9 Të dhëna të tjera që do të gjykohen të nevojshme nga Banka e Shqipërisë.

Neni 4

4.1 Një bankë e huaj që kërkon të marrë licencë për të kryer veprimtari bankare, i dërgon Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet drejtorit të departamentit të mbikëqyrjes, një kërkesë me shkrim që përmban:

4.1.1 Detaje për transaksionet bankare që ajo do të kryejë nëpërmjet degës në Shqipëri.

4.1.2 Emri, zyra ku është regjistruar, adresa e Drejtorisë së Përgjithshme të bankës së huaj, si dhe adresën e saj për korrespondencë.

4.1.3. Emri dhe adresa e degës që mendohet të hapet në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe një adresë për korrespondencë.

4.2 Duhet të paraqiten:

4.2.1 Një kopje e aktit të regjistrimit të bankës së huaj në vendin ku banka është krijuar.

4.2.2 Një kopje të dokumentit që vërteton kapitalin e regjistruar të bankës së huaj që kërkon të hapë një degë të saj në Shqipëri.

4.2.3 Një dokument që vërteton se banka mëmë ka paguar shumën minimale të kapitalit të paprekshëm që kërkohet për hapjen e një dege në Shqipëri, depozituar në një llogari të bllokuar në Bankën e Shqipërisë.

4.2.4 Plani i biznesit për tre vitet e para të veprimtarisë, i cili do të përmbajë të dhëna sipas nenit 3.3 të kësaj rregulloreje.

4.2.5 Një kopje e vendimit të organit kompetent për zgjedhjen/emërimin e personave të cilët do ta drejtojnë dhe përfaqësojnë degën e bankës së huaj, emrat dhe adresat e tyre, të dhënat për kualifikimin dhe përvojën bankare sipas kërkesave të nenit 3.1.2 të kësaj rregulloreje.

4.2.6 Raportet financiare të bankës së huaj për tre vitet e fundit.

4.2.7 Një letër nga organi kompetent i mbykqyrjes, mbi transaksionet bankare në vendin ku vepron banka mëmë, duke e specifikuar nëse legjislacioni bankar i vendit të vet e lejon bankën të kryejë transaksione bankare në Shqipëri nëpërmjet një dege ose nëse organi i mbikëqyrjes jep pëlqimin e tij që të hapet një degë, nëse një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni i vendit.

Neni 5

Verifikimi i dokumenteve dhe afatet

5.1 Banka e Shqipërisë organizon verifikimin e nevojshëm të vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura, si dhe të saktësisë të të dhënave të pasqyruara në to, me qëllim që të konstatojë se në çfarë shkalle janë plotësuar kërkesat për dhënie licence.

5.2 Banka e Shqipërisë merr vendim për pranim ose refuzim të kërkesës për dhënie licence për bankë brenda 90 ditëve pas paraqitjes së kërkesës dhe të dokumenteve të tjera të kërkuara.

5.3 Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë apo nuk përmbushen kërkesat e ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar në Shqipëri”, apo kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore ose nëse nevojitet informacion shtesë, brenda dy muajve pas paraqitjes së dokumenteve, Banka e Shqipërisë do të dërgojë një njoftim për mangësitë, konfliktet me ligjin apo informacionin shtesë që kërkohet.

5.4 Personat që kanë mangësi në kërkesën e paraqitur sipas nenit 5.3, duhet t'i mënjanojnë ato brenda një muaji pasi është marrë njoftimi.

5.5 Në këtë rast vendimi për pranim apo refuzim të kërkesës për dhënie licence sipas nenit 5.2. llogaritet nga dita e paraqitjes së plotë të kërkesës për licencë.

Neni 6

Pranimi apo refuzimi i kërkesës për dhënie licence

6.1 Vendimi për të dhënë ose refuzuar dhënien e licencës merret nga Banka e Shqipërisë sipas nenit 9 të ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar në Shqipëri”.

6.2 Dhënia e licencës, ose refuzimi për ta dhënë atë, i bëhet e njohur me shkrim kërkuar nga Banka e Shqipërisë brenda shtatë ditëve pas marrjes së vendimit përkatës.

6.3. Në licencën e dhënë, Banka e Shqipërisë cakton edhe afatin maksimal të fillimit të veprimtarisë bankare.

Neni 7

Regjistrimi në gjykatë dhe në Bankën e Shqipërisë

7.1 Në mbështetje të nenit 8 të ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar në

Shqipëri”, personat që paraqesin kërkesë për licencë për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë, kërkesën duhet ta shoqërojnë me kopjen e aktit të regjistrimit si person juridik.

7.2 Në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar në Shqipëri”, Banka e Shqipërisë mban regjistër ku evidencohen: emërtimi, adresa dhe vendndodhja e bankës që i është dhënë licenca.

7.3 Dhënia dhe revokimi i licencave për të vepruar si bankë shpallen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Kërkesat për të filluar kryerjen e transaksioneve bankare

Personat që janë pajisur me licencë për të vepruar si bankë lejohet të fillojnë operacionet bankare vetëm pasi t’i kenë dërguar drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës të Shqipërisë, dokumentet e mëposhtme:

8.1 Formularin nr.3 dhe bashkëlidhur këtij dokumentin bankar që vërteton se është depozituar (derdhur) në një llogari të bllokuar në Bankën e Shqipërisë pjesa e mbetur e kapitalit sipas nenit 2.6 (gërma a, b.1 dhe c.1) të kësaj rregulloreje.

8.2 Një kopje e statutit të hartuar në përputhje me licencën e dhënë, listë të drejtuesve të bankës dhe përshkrim të shkurtër të kompetencave të tyre së bashku me specimentet e nënshkrimit.

8.3 Një kopje të aktit të pronësisë ose të kontratës së qerasë për lokalet ku do të kryhen operacionet bankare.

8.4 Dokumente të tjera të lëshuara nga organet e Ministrisë së Rendit Publik ku të tregohet nëse lokalet e bankës i plotësojnë kërkesat për siguri dhe mbrojtje, si dhe lehtësitë e tjera komunikuese dhe mbrojtjeje.

8.5 Një vërtetim mbi sigurimin nga zjarri të lokaleve të Bankës, të lëshuar nga organet kompetente për parandalimin e zjarreve.

8.6 Të dhëna të detajuara për mundësitë teknike dhe pajisjet e kërkuara për të kryer operacione bankare (kompjuteri, telefona, telekse, faks etj.).

Neni 9

Informacione dhe të dhëna të kohës

9.1 Personat, të cilët kanë marrë licencë për të vepruar si bankë duhet të njoftojnë me shkrim drejtorin e Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës të Shqipërisë për të gjitha faktet e reja e rrethanat e konstatuara kohët e fundit, si dhe për ndryshimet e plotësimet në dokumente, të cilët kanë shërbyer si bazë për dhënien e licencës.

9.2 Njoftimi sipas paragrafit 9.1. duhet bërë brenda 7 ditëve, pasi të vërtetohet fakti përkatës ose pasi janë bërë ndryshimet e plotësimet në dokumente.

Neni 10

Regjistrimi i transaksioneve

10.1 Personat që kanë marrë licencë për të vepruar si bankë duhet t’i regjistrojnë transaksionet e kryera në librat dhe regjistrat kontabël jo më vonë se mbarimi i ditës së punës kur këto transaksione janë kryer sipas dispozitave ligjore dhe udhëzimeve të lëshuara për këtë qëllim.

10.2 Transaksionet bankare regjistrohen në librat e regjistrat përkatës kontabël sipas radhës së kryerjes së tyre.

10.3 Organet e Mbikëqyrjes së Bankës të Shqipërisë kanë të drejtë që në çdo kohë gjatë orëve të punës dhe në çdo vend ku kryhen operacionet bankare të kryejnë inspektime e kontrolle për qëllimin e kryerjes së transaksioneve, mënyrën e kryerjes së tyre, si dhe të kontrollojnë çdo

libër dhe regjistër ku pasqyrohen transaksionet bankare.

10.4 Përderisa të mos jetë thënë ndryshe në ndonjë dispozitë tjetër ligjore, të gjitha dokumentet kontabël dhe ato të arkës, si dhe librat e regjistrat përkatës që pasqyrojnë transaksionet e kryera, ruhen për një afat jo më të vogël se dhjetë vjet.

Neni 11

Revokimi i licencës

11.1 Banka e Shqipërisë mund të revokojë, licencën e dhënë në rastet e përcaktuara në nenin 10 të ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar në Shqipëri” ose kur Banka nuk fillon veprimtarinë në afatin maksimal të përcaktuar në licencën e dhënë nga Banka e Shqipërisë.

11.2 Vendimi për revokimin e licencës i njoftohet me shkrim mbajtësit të licencës së revokuar brenda 7 ditëve nga marrja e vendimit. Në të njëjtën kohë akti i revokimit botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

11.3 Licenca e revokuar i kthehet Bankës së Shqipërisë brenda 7 ditëve pas marrjes së njoftimit për revokimin e saj.

Neni 12

Regjistri

12.1 Të gjitha licencat e dhëna sipas afateve e procedurave të kësaj rregulloreje regjistrohen në një regjistër të veçantë që e mban Banka e Shqipërisë.

12.2 Në regjistër shënohen emërtimi, adresa dhe vendndodhja e bankës së licencuar.

12.3 Banka me licencë të revokuar, çregjistrohet.

Neni 13

Komisioni për kompensimin e shpenzimeve të përpunimit, korrespondencës dhe për informacione të tjera

13.1 Për të kompensuar shpenzimet e përpunimit të dokumenteve që përmban kërkesa për dhënie lincensë, si dhe shpenzime të tjera për zhvillimin e korrespondencës, për verifikimin e saktësisë e të plotësisë së dokumenteve etj., Banka e Shqipërisë merr nga kërkesit një komision në momentin kur ato paraqesin kërkesën dhe dokumentet e tjera.

13.1.1 Për kërkesën për të hapur një bankë, apo një degë të një banke të huaj, komisioni caktohet 500 000 lekë, ndërsa për një agjensi të një banke të huaj, 200 000 lekë.

13.1.2 Për kërkesat për zgjerimin apo ndryshimin e rrjetit të Bankës brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, komisioni caktohet 200 000 lekë dhe për ndryshimin e zonës ku vepron banka, 100 000 lekë.

Me ndryshim të rrjetit të Bankës kuptohet mbyllja e një dege ose agjensie bankare, si dhe kalimi nga degë banke në asgjensi bankare, ose nga agjensi bankare në degë Banke.

KREU 4

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Pjesë e pandarë e kësaj rregulloreje janë:

a. Rregullat procedurale për përpunimin e kërkesës për licencë.

b. Kërkesa për licencë së bashku me formularët bashkëlidhur.

Neni 15

Përveç informacionit që jepet në formularët që përmenden në nenin 14, kërkuesi duhet t'i përgjigjet edhe gjithë kërkesave të tjera të kësaj rregulloreje, në rast të kundërt Departamenti e konsideron si një shkak për mosdhënien e licencës.

Neni 16

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të ligjit nr.7559, datë 22.4.1992 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të neneve 8 deri 14 të ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar në Shqipëri”.

Neni 17

Kjo rregullore është miratuar nga Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.1, datë 12.5.1994 dhe rregulloret e lëshuara para kësaj date shfuqizohen.

Neni 18

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.